



SIGURIA KIBERNETIKE

PËR

BIZNESET E VOGLA

SIGURIA FIZIKE

Siguria kibernetike fillon me siguri të fortë fizike.

Gabimet në sigurinë fizike mund të ekspozojnë të dhënat e ndjeshme të kompanisë ndaj vjedhjes së identitetit, me pasoja potencialisht serioze. Për shembull:

Një punonjës harron aksidentalisht një flash drive në tavolinën e një restoranti. Kur ai kthehet disa orë më vonë për ta marrë atë, pajisja - me qindra numra të Sigurimeve Shoqërore të ruajtura në të - është zhdukur.

Një tjetër punonjës hedh dokumentat me të dhënat bankare të kompanisë së vjetër në një kosh plehrash, ku një sulmues i gjen pas orarit të punës.

SI TË MBRONI PAJISJET & DOKUMENTET FIZIKE

Ndiqui disa këshilla për mbrojtjen e informacionit në dokumentat tuaj fizikë dhe në pajisjet elektronike si: flash drive, hard-drive, laptop etj.



Ruani në mënyrë të sigurt

Nëse dokumentet ose pajisjet elektronike përmbajnë informacione të ndjeshme, ruajini ato në një kabinet ose dhomë të mbyllur.



Kufizoni aksesin fizik

Kur dokumentet përmbajnë të dhëna të ndjeshme, lejoni akses vetëm për personat e autorizuar



Rikujtoni punonjësit

Kujtojeni punonjësve të vendosin dokumentat në kabinetet të mbyllura, të bëjnë *logout* nga rrjeti dhe aplikacionet dhe të mos i lënë kurrë skedarët ose pajisjet me të dhëna të ndjeshme pa mbikëqyrje.



Siguroni pajisjet

Siguroni çdo pajisje që mbledh informacione të ndjeshme ndaj klientit. Mbani vetëm skedarë dhe të dhëna që ju nevojiten dhe dini se kush ka akses në to.

SI TË MBRONI TË DHËNAT NË PAJISJET TUAJA

Nëse humbisni një pajisje ka më pak gjasa që informacioni juaj të jetë në rrezik nëse informacioni në ato pajisje është i mbrojtur. Ndiqni më poshtë disa mënyra se si të mbroni pajisjet tuaja:



Krijoni fjalëkalime komplekse

Krijoni fjalëkalime që janë të gjata, komplekse dhe unike dhe sigurohuni që këto fjalëkalime të ruhen në mënyrë të sigurt.



Përdorni autentifikimin me shumë faktorë

Kërkoni vërtetim me shumë faktorë për të hyrë në zonat e rrjetit tuaj me informacione të ndjeshme.



Kufizoni përpjekjet për login

Kufizoni numrin e përpjekjeve të lejuara për të bërë login për të zhbllokuar pajisjet. Kjo do të ndihmonte në mbrojtjen kundër ndërhyrësve të huaj.



Enkriptoni

Enkriptoni pajisjet që përmbajnë informacione të ndjeshme së bashku me të dhënat që dërgoni jashtë kompanisë, si për shembull: te një kontabilist ose një shërbim transporti.

TRAJNONI stafin



Asgjësoni dokumentet

Gjithmonë grisni dokumentet me informacione të ndjeshme përpara se t'i hidhni ato.

Fshini saktë të dhënat

Përdorni një program për të fshirë të dhënat përpara se t'i hidhni pajisjet tuaja.

Promovoni praktikat e sigurisë

Ruani praktikat e sigurisë edhe nëse punoni nga shtëpia apo jeni në udhëtime pune.

Krijoni një plan

I gjithë stafi duhet të dijë se çfarë të bëjë nëse pajisjet ose dokumentet fizikë humbasin ose vidhen, duke përfshirë kë të njoftojnë dhe çfarë të bëjnë më pas.